



Building a Greener Economic Environment

THIRRJE PËR PROPOZIME PËR GRANTE

Nr. Ref.: EA_038/01-2024

TITULLI I PROJEKTIT:

“PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE PËR ZHVILLIMIN NDËRKUFITAR SOCIO-EKONOMIK TË ZONAVE TË MBROJTURA NË MAQEDONINË E VERIUT DHE SHQIPËRI (KORAB-KORITNIK, SHARR DHE ALPET SHQIPTARE)”

Dorëzimi i propozimeve të projekteve nga aplikantët e përfshirë në zonën e projektit që përfshin rajonin e Parkut Kombëtar Mali Sharr dhe Parkut Kombëtar të Mavrovës (Maqedonia e Veriut) konkretisht në komunat e Tearcës, Jegunovcës, Tetovës, Bogovinës, Vrapçishtit, Gostivarit dhe Mavrovë-Rostushes me fokus në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar social-ekonomik të zonave të mbrojtura.

Prezantim i CNVP-së

CNVP-ja është një organizatë me seli në Holandë që vepron në Ballkan. Misioni ynë është të promovojmë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të ofrojmë mbështetje për komunitetet dhe pushtetet lokale për të krijuar një jetë që është në harmoni me natyrën. Nëpërmjet projekteve të ndryshme, ne synojmë të kontribuojmë për një Evropë më të mirë Juglindore duke u fokusuar në gjashtë fusha kryesore:

1. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
2. Ndryshimet klimatike
3. Zhvillimi rural
4. Energjia e rinovueshme
5. Mobilizimi i komunitetit
6. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian

CNVP-ja, përmes zyrave të saj në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, po zbaton projektin trevjeçar “Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar socio-ekonomik të zonave të mbrojtura në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri (Korab-Koritnik, Malin Sharr dhe Alpet Shqiptare)”, i financuar nga Fondi i Natyrës “Prespa-Ohri” (PONT).

Ky grant bazohet në përvijën e CNVP-së në Prespë, i mbështetur nga PONT, si dhe në punën tonë të gjerë në vendet e Ballkanit gjatë shumë viteve me mbështetjen e donatorëve të tjerë.

Projekti synon të përmirësojë kushtet socio-ekonomike të komuniteteve lokale, duke kontribuar në të njëjtën kohë në ruajtjen e natyrës. Ai fokusohet posaçërisht në përdorimin e qëndrueshëm të produkteve



Building a Greener Economic Environment

pyjore jodrunore (PPJD) dhe turizmin e bazuar në natyrë, duke përdorur një qasje pjesëmarrëse, ndërkuftare dhe ndërsektoriale.

Projekti ka tre objektiva kryesore:

1. Përdorimi i qëndrueshëm i produkteve pyjore jodrunore në zonat e mbrojtura të Malit Sharr, Korab-Koritnikut dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e komuniteteve lokale në këto zona të mbrojtura,
2. Turizmi i bazuar në natyrë (TBN) në zonat e mbrojtura të Malit Sharr, Korab-Koritnikut dhe Alpeve Shqiptare duke kontribuar në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e komuniteteve lokale në këto zona të mbrojtura.
3. Zhvillimi i një mekanizmi për menaxhimin e Malit Sharr, Korab-Koritnikut dhe Alpeve Shqiptare që mundësojnë zhvillimin e turizmit të bazuar në natyrë dhe mënyra të tjera të përdorimit të burimeve natyrore në këto zona të mbrojtura:

Grantet janë të destinuara kryesisht për përfituesit e kualifikuar me një prani lokale në zonat e mbrojtura dhe me mision dhe strategji të fokusuar në ruajtjen e natyrës. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë pjesëmarrjen e qytetarëve në përpjekjet për ruajtjen, zhvillimin e shoqërive të qëndrueshme dhe të komuniteteve lokale dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Thirrja e hapur për propozimet për grante do të reklamohet në faqen e internetit të CNVP-së dhe në kanalet e saj në mediat sociale.

Informacion i përgjithshëm për grantin

Alokimi financiar i ofruar nga Ofruesi i Grantit (CNVP)

Shuma e përgjithshme e vënë në dispozicion në këtë thirrje për projekt propozime është **73,000 EUR**. Ofruesi i grantit rezervon të drejtën të mos kontraktoj të gjitha fondet e disponueshme.

Madhësia e granteve

Çdo grant i kërkuar sipas kësaj thirrjeje për projekt propozime duhet të jetë ndërmjet shumave minimale dhe maksimale të mëposhtme:

- shuma minimale: EUR 5,000
- shuma maksimale: EUR 20,000

Kohëzgjatja e zbatimit të grantit duhet të jetë 12 muaj.

Të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim janë në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe, dhe secili aplikant mund të zgjedhë gjuhën në të cilën dëshiron të aplikojë.

Gjatë periudhës së thirrjes së hapur për grante, sesionet informative do të zhvillohen në datat 10 dhe 13 Maj (vendi dhe detaje të tjera do të vijojnë më tej), aplikantët potencialë do të mund të bëjnë pyetje në



Building a Greener Economic Environment

lidhje me dokumentacionin që do të dorëzohet. Ju lutemi dërgoni pyetjet tuaja deri më 9 maj 2024, deri në orën 16:00. Të gjitha pyetjet nga aplikantët mund të dërgohen në adresën e emailit q&a@cnvp-eu.org.

Propozimet e plota të projektit duhet të merren vetëm në mënyrë elektronike në adresën e mëposhtme të emailit: contact@cnvp-eu.org, afati i fundit i dorëzimit është jo më vonë se data **23 Maj (e enjte), 2024** deri në orën 16:00. Gjatë dërgimit të aplikacionit në seksionin Subjekt, është e detyrueshme të tregohet numri i referencës së numrit të thirrjes (Nr. Ref.: EA_038/01-2024).

Aplikantët e kualifikuar për financim

Për t'u kualifikuar për grant, aplikanti duhet:

- të jetë organizatë jofitimprurëse e regjistruar sipas ligjit të shoqatave dhe fondacioneve në Maqedoninë e Veriut
- Aplikantët duhet të jenë të vendosur në territorin e komunave Tearcë, Jegunovcë, Tetovë, Bogovinë, Vrapçisht, Gostivar dhe Mavrovë dhe Rostusë.
- aplikanti duhet të jetë aktiv 12 muajt e fundit nga data e publikimit të thirrjes.

E rëndësishme:

- **Aplikantët që kanë të përfshirë persona të punësuar në zonat e mbrojtura të Parkut Kombëtar Mali Sharr dhe Parkut Kombëtar të Mavrovës (anëtarë të këshillave drejtuese, personel administrativ dhe personel teknik) dhe njëkohësisht janë anëtarë të organeve administrative dhe drejtuese ose veprojnë si staf/ekspertë në personin juridik që aplikon nuk kanë të drejtë të aplikojnë në thirrje.**
- **Aplikantët që aktualisht po zbatojnë projekte të financuara nga PONT nuk janë të kualifikuar të aplikojnë për këtë thirrje.**

Skema e nën-granteve mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve për organizatat lokale për përmirësimin e kapaciteteve teknike (punëtori, vizita studimore ndërkufitare) duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit jetësor, nga perspektiva e TBN, PPJD dhe biodiversitetit.
- Ngritja e vetëdijes dhe trajnimi i komuniteteve lokale për grumbullimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve në zonat e mbrojtura (praktikat dhe rregulloret e mbledhjes së qëndrueshme, mjetet alternative të jetesës, ruajtja, efektet ndërkufitare dhe bashkëpunimi me autoritetet)
- Përmirësimi i mekanizmave për përdorimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMA-ve (aftësitë sipërmarrëse, promovimi, zhvillimi i produkteve pyjore jodrunore, bimëve mjekësore dhe aromatike, dhe turizmit të bazuar në natyrë).
- Prokurimi i pajisjeve për përmirësimin e objekteve për përpunimin dhe tharjen e produkteve pyjore jodrunore dhe bimëve mjekësore dhe aromatike (Llojet e pajisjeve: pranimi, mbledhja dhe ruajtja, përgatitja për klasifikim, pastrimi, larja, tharja, dezinfektimi, klasifikimi, kalibrimi, heqja e frutave të dëmtuara, pajisjet për prerje, bluarje dhe pajisje të tjera për përgatitje para përpunimit,

pajisje për konservim, tharje, ngrirje, pajisje mbushëse, futja në shishe, ambalazhimi dhe shënimi/etiketimi, pajisje për monitorimin e cilësisë, sisteme kontrolli me mundësi për gjurmimin e pranimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së produktit).

- Certifikimi për mbledhësit organikë.
- Përmirësimi i kapaciteteve për kultivimin organik të produkteve pyjore jodrunore dhe bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave (Ofrimi i trajnimeve, burimeve dhe mbështetjes për komunitetet lokale për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë praktika kultivimi të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin jetësor, për të krijuar lidhje tregu, dhe për të promovuar praktika të qëndrueshme).
- Krijimi i konsoliduesve lokalë për BMA-të dhe produktet e tjera pyjore jodrunore për të garantuar tregti të drejtë dhe praktika të qëndrueshme të mbledhjes (partneritetet me komunitetet lokale, promovimi i praktikave të qëndrueshme të mbledhjes, ofrimi i trajnimeve dhe burimeve dhe sigurimi i çmimeve të drejta).
- Prokurimi i pajisjeve për përpunimin dhe prodhimin e ushqimit tradicional nga ofruesit e shërbimeve turistike të bazuara në natyrë (pajisje për përpunim: prerës, bluarës dhe dehidratues, pajisje për prodhim: furra, soba dhe enë, pajisje për turizmin e bazuar në natyrë, si p.sh. pajisje për bjeshkatari dhe kamping, pajisje për turizëm aventurier, pajisje për sporte ujore, vëzhgim të kafshëve të egra etj.).
- Promovimi i tureve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të mbështetur ekonominë lokale dhe për të ruajtur traditat kulturore. Mund të mbështeten edhe aktivitetet ndërkufitare për promovim.
- Krijimi/përmirësimi i kapaciteteve dhe objekteve akomoduese private pranë ofruesve të shërbimeve turistike/produkteve të bazuara në natyrë (për krijimin, pajisjen apo rinovimin e objektit sipas traditës në vend).
- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve turistike në zonat e mbrojtura të bazuara në natyrë.

E rëndësishme: Kjo listë nuk është e kufizuar.

Procesi i vlerësimit

Procedura për vlerësimin e aplikimeve përbëhet nga dy faza, kontrolli administrativ dhe vlerësimi i aplikimeve. Vetëm aplikimet që e kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit. Gjatë kontrollit administrativ kontrollohet plotësia e kushteve të mëposhtme:

- Afati i aplikimit të pranuar;
- Plotësia e aplikimit;
- Plotësia e saktë të aplikimit;
- Nëse janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë;

Nëse aplikimi nuk i plotëson këto kushte, ai do të refuzohet dhe aplikanti do të njoftohet për këtë. Komisioni i pavarur vlerësues do t'i zgjedhë propozimet më të mira të projekteve që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përshkruara më sipër. Komisioni vlerësues do të përbëhet nga një numër tek



Building a Greener Economic Environment

individësh dhe do t'i vlerësojë aplikimet e pranuar në kuadër të kësaj thirrjeje. Kriteret e vlerësimit dhe pesha e tyre për përfituesit e mundshëm janë transparente dhe të hapura për publikun. Lista e grantistëve të përzgjedhur për financim do të shpallet publikisht.

Dokumentet e nevojshme për dorëzim

- Formulari i aplikimit, Shtojca 1, i plotësuar sipas shablloneve;
- Formati i buxhetit, Shtojca 2, i dorëzuar në versionin excel;
- CV-të e stafit të projektit të përfshirë në propozimin e projektit;
- Dokumenti zyrtar i regjistrimit nga Regjistri Qendror (jo më i vjetër se 3 muaj);
- Raporti financiar për vitin 2023 (e cila është dorëzuar në Rregjistrin qendror)
- OJQ-të, të ardhurat totale të të cilave janë nën 2,500 euro, duhet të paraqesin deklaratë se nuk kanë dorëzuar raport vjetor për vitin 2023;
- Deklarata e aplikantit dorëzohet me nënshkrim dhe vulë;

Afati kohor indikativ

Afati kohor indikativ	Data
Shpallja e Thirrjes	19 Prill 2024
Sesionet informative	10 Maj and 13 Maj 2024
Afati i fundit për pyetje dhe kërkesa për sqarime	9 May 2024
Afati i fundit për aplikim	23 (E enjte) Maj 2024
Procesi i evaluimit dhe përzgjedhja e fituesve	21 Qershor 2024
Njoftimi për aplikimet e suksesshme	27 Qershor 2024 <i>(data e përkohshme)</i>
Nënshkrimi i kontratës	28 Qershor 2024 <i>(data e përkohshme)</i>